



Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës
Association of Journalists of Kosovo

Statuti i Asociacionit të Gazetarëve të Kosovës

Bazuar në Ligjin nr. 06/L- 043 për Lirinë e Asociimit në Organizata Joqeveritare i miratuar me datë; 19 korrik 2021, Kuvendi i Anëtarëve të Asociacionit të Gazetarëve të Kosovës, për të qeverisur organizatën miraton këtë statut.

Neni 1

Emri, forma dhe adresa

1. Emri i organizatës është Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës.
2. Ajo njihet edhe me shkurtesën AGK.
3. AGK është shoqatë jofitimprurëse, e definuar sipas nenit 16 dhe 20 të Ligjit nr. 06/L- 043, për Lirinë e Asociimit në Organizata Joqeveritare në Republikën e Kosovës.
4. AGK nuk bënë shpërndarjen e asnjë të ardhure neto, apo fitim për asnjë person. Pasuria, të ardhurat dhe fitimet, të cilat organizata i realizon sipas mandatit të saj si organizatë joqeveritare, nuk përdoren për përfitime të veçanta të individëve, qoftë ajo në mënyrë të drejtpërdrejt apo tërthorazi për asnjë prej themeluesve, udhëheqësve, anëtarëve, të punësuarve apo partnerëve (donatorëve) të saj. Kompensimi i arsyeshëm i këtyre personave mund të bëhet për angazhime të caktuara në zhvillimin e veprimtarisë së AGK-së.
5. Çdo transaksion ndërmjet AGK-së dhe një organizate tjetër të ndërlidhur, apo ndërmjet OJQ-së dhe anëtarëve, zyrtarëve, anëtarëve të bordit ose punonjësve të saj ndalohet, përveç, nëse organi drejtues vendosë, pas hetimeve të arsyeshme, se transaksioni është në interes, i drejtë dhe i arsyeshëm për organizatën dhe se i njëjti nuk kishte mundur të sigurojë marrëveshje më të favorshme me përpjekje të arsyeshme dhe brenda rrethanave ekzistuese.
6. Bazuar në paragrafin 2 të nenit 35 të Ligjit nr. 06/L- 043, në përputhje me nenin 12 të të njëjtit ligj që përcakton karakterin jofitimprurës të organizatës, AGK ka të drejtë të angazhohet në aktivitete ekonomike me kusht që të ardhurat e realizuara të shfrytëzohen për arritjen e qëllimeve të përcaktuara me këtë statut.
7. AGK përkrah parimet e Deklaratës së Federatës Evropiane të Gazetarëve (EFJ) dhe të Federatës Ndërkombëtare të Gazetarëve për lirinë e gazetarëve dhe të medias në Evropë, e miratuar më 5 mars 1993 përkatësisht më 2 mars të vitit 1995.
8. AGK ka logon e cila do të jetë shenjë mbrojtëse e organizatës si dhe vulën e vet.
9. Selia e AGK-së është në Prishtinë.

Neni 2

Qëllimi dhe fushëveprimi

1. Qëllimi kryesor i AGK-së është të mbrojtë të drejtat dhe liritë e gazetarëve, kameramanëve dhe fotoreporterëve, të promovojë gazetarinë e lirë, hulumtuese, të pavarur dhe profesionale. Për të arritur këtë, AGK angazhohet në:

Miratimin e kodit profesional të sjelljes (kodin e etikës) me qëllim të ngritjes së vetëdijes së anëtarësisë sonë për etikën profesionale.

Promovimin e të drejtave sociale dhe profesionale të gazetarëve.

Promovimin e solidaritetit në mesin e anëtarëve si dhe përfaqësimin dhe mbrojtjen e interesave të tyre pranë autoriteteve relevante.

Të ngritë, zhvillojë dhe të mirëmbajë forma të bashkëpunimit me organizata të ngjashme jashtë vendit.

2. Fushëveprimi i këtij statuti shtrihet në mbrojtjen e të drejtave të komunitetit që AGK përfaqëson, në gjithë territorin e Kosovës, dhe respektimin e të drejtave të njohura me ligj, gjatë punës së tyre.

Neni X

Parimet

1. Parimi i pavarësisë – AGK është organizatë e pavarur nga çfarëdo forme e ndikimit politik, ideologjik, fetar, racor apo çfarëdo ndikimi tjetër që bie ndesh me parimet dhe standardet e demokracisë.
2. Parimi i transparencës – puna dhe aktivitetet e AGK-së mbështeten në transparencë, llogaridhënie dhe përgjegjshmëri në të gjitha fazat e veprimtarisë së saj, ashtu siç përcaktohet në ligj dhe aktet tjera normative të brendshme.
3. Parimi i lirisë së shprehjes – AGK është e organizuar dhe funksionon sipas parimeve të lirisë së shprehjes në frymën e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut si dhe bazuar në Kushtetutën e Republikë së Kosovës.

Neni 3

Anëtarësimi

1. Anëtarësimi në organizatë është i hapur për:

Çdo gazetar, kameraman, fotoreporter, redaktor, redaktor përgjegjës, kryeredaktor, drejtor i informacionit, pa marrë parasysh racën, gjininë, kombësinë, religjionin të cilit i përket.

2. Mospagesa e anëtarësisë (pas fillimit të aplikimit të pagesës), pas paralajmërimit në të shkruar, do të shërbejë si bazë për përjashtimin e anëtarit nga organizata.

Anëtarësimi i ndonjë anëtari gjithashtu mund të përfundojë ose suspendohet me vendimin e Bordit të AGK-së në këto raste:

nëse braktisin profesionin e gazetarit,

nëse shkelin normat e statutit të AGK-së,

Neni 4

Organet e AGK-së

1. Organet e AGK-së janë:

Kuvendi i Anëtarëve,

Bordi i AGK-së,

Kryetarja/i e/i AGK-së,

Drejtoresha/Drejtori dhe Stafi Ekzekutiv.

2. Secili anëtar i AGK-së mund të jetë i zgjedhur në organet drejtuese të saj, me përjashtim që gazetarët kameramanët dhe fotoreporteret, të cilët janë pronarë mediesh, bashkëpronarë ose aksionarë mediesh, drejtorë ekzekutiv, drejtorë gjeneral, zv. drejtorë gjeneral, nuk kanë të drejtë përfaqësimi dhe as vote në organet drejtuese të AGK-së. Ata që janë të zgjedhur dhe kanë mandat drejtues në organet e AGK-së, në momentin që do të bëhen pronarë mediesh apo kalojnë në ndonjërin në pozitë të theksuara më lartë të nenit 4, pika 2, u pushon mandati.

Neni 5

Kuvendi i anëtarëve

1. Kuvendi i AGK-së është organi më i lartë qeverisës dhe vendimmarrës, i cili përbëhet prej të gjithë anëtarëve të tij. Kuvendi posaçërisht ka përgjegjësi në përcaktimin e politikave të përgjithshme të organizatës, mbikëqyrjen e organeve të saj varëse, me theks të veçantë në menaxhimin e financave të AGK-së.
2. Kompetencat e kuvendit janë:
Zgjedh dhe shkarkon Kryetarin e Bordit Drejtues;

- Zgjedh dhe shkarkon anëtarët e bordit;
- Miraton dhe ndryshon statutin dhe aktet tjera të brendshme;
- Miraton dokumentet që dalin nga mbledhjet e rregullta dhe të jashtëzakonshme të kuvendit me karakter procedural;
- Vendosë mbi shpërbërjen e organizatës.
3. Anëtarët e bordit zgjedhen nga listat e kandidatëve, të cilat përmbajnë së paku 10 (dhjetë) propozime të anëtarëve të kuvendit.
- Mënyra e votimit është preferenciale, ku secili prej anëtarëve të kuvendit mund të votojë 1 deri në 5 anëtarë nga lista prej së paku 10 (dhjetë) kandidatëve të propozuar.
- Tetë (8) kandidatët nga së paku 10 (dhjetë) propozimet, të cilët kanë marrë numrin më të madh të votave zgjedhen anëtarë të bordit.
4. Kryetari/ja i/e AGK-së është anëtari i 9 (nëntë), e cila/i cili zgjidhet drejtpërdrejt nga kuvendi.
- Kryetari/ja zgjidhet nga lista prej 2 e më shumë kandidatëve. Kryetar/e zgjidhet kandidatja/iqë merr shumicën e votave.
- Votimi për kryetare/kryetar dhe anëtarë të bordit, bëhet njëkohësisht, por me fletëvotime të ndara.
5. Të gjithë kandidatët për kryetare dhe anëtarë të bordit duhet të dërgojnë kandidaturat e tyre në adresën zyrtare të AGK-së, më së voni 3 ditë para ditës së mbajtjes së zgjedhjeve.
6. Të drejtë kandidimi për kryetare/kryetar dhe anëtarë të Bordit të AGK-së kanë kandidatët që kanë pesë (5) apo më shumë vite përvojë pune në gazetari aktive.

Neni 6

Mbledhjet e kuvendit

1. Me kërkesën e shumicës së anëtarëve të bordit, bordi ka për obligim të thërras kuvendin e jashtëzakonshëm.
2. Lajmërimi me shkrim për mbledhjen duke përfshirë datën dhe vendin e mbajtjes së mbledhjes, së bashku me rendin e ditës për takimin do t'u shpërndahet të gjithë anëtarëve së paku pesë ditë para mbajtjes së mbledhjes.
3. Kuvendi mund të zhvillojë punimet e tij vetëm nëse marrin pjesë 50% e anëtarësisë.

4. Secili anëtar i organizatës ka të drejtën e një vote.
5. Kryetari/ja i AGK-së hapë punimet e kuvendit dhe udhëheq ato deri në momentin e zgjedhjes të kryesisë së punës. Nëse mungon kryetarja/i punimet i hap dhe udhëheqë njëri nga anëtarët e deleguar nga kryetarja/i.

Neni 7

Bordi

1. Bordi është përgjegjës për kontrollimin dhe udhëheqjen e punëve të organizatës. Bordi vepron në pajtim me qëllimet e organizatës.
2. Përpos kompetencave të cekura më lartë në këtë statut, Bordi do të ketë gjithashtu edhe këto kompetenca:

Të miratojë programin dhe strategjinë e AGK-së në pajtim me qëllimet dhe objektivat e Asociacionit.

Të implementojë politikën e përgjithshme dhe orientimin gjeneral të aktiviteteve të aprovuara nga Kuvendi i Anëtarëve, në pajtim me normativen e AGK.

Të shqyrtojë raportet e punës dhe financiare nga Kryetarja/i dhe Drejtoresha Ekzekutive/ Drejtori Ekzekutiv para se ato t'i parashtrohen në shqyrtim mbledhjes së Kuvendit.

Të shqyrtojë dhe të marrë parasysh planin e programit vjetor dhe buxhetin e përgatitur dhe të parashtruar nga ana e Drejtoreshës Ekzekutive/Drejtorit Ekzekutiv.

Të mbikëqyrë buxhetin e Asociacionit dhe miratojë raportet financiare nga Drejtoresha Ekzekutive/ Drejtori Ekzekutiv.

T'i propozojë Kuvendit shkarkimin apo zgjedhjen e anëtarit të ri të Bordit.

Të zgjedhë sipas nevojës stafin e AGK-së, ekspertët, bashkëpunëtorët e jashtëm të Asociacionit si dhe të vendosë për çdo lloj bashkëpunimi të AGK-së me palë të treta.

Të përditësoj rregulloret e brendshme të funksionimit të AGK-së.

T'i propozojë Kuvendit ndryshimet dhe plotësimet në këtë Statut.

Të emërojë dhe shkarkojë Drejtoreshën Ekzekutive/ Drejtorin Ekzekutiv.

Të mbikëqyrë përfaqësimin e Asociacionit nga ana e Kryetares/it para organeve dhe autoriteteve relevante në Kosovë dhe jashtë saj.

3. Bordi mund të marrë vendime vetëm kur shumica e anëtarëve janë të pranishëm dhe me shumicën e votave të të pranishmëve.
4. Bordi do të mbledhet sipas nevojës, por së paku një herë në muaj. Bordi do të jetë i obliguar të thërrasë mbledhjen nëse një gjë e tillë kërkohet nga shumica e anëtarëve të Bordit. Nëse ndonjë anëtar i Bordit mungon pa arsye më shumë se dy herë, ajo/ai do të shkarkohet nga pozita e anëtarit të Bordit.
5. Bordi do të jetë në përbërje prej nëntë (9) anëtarëve, përfshirë edhe kryetaren/in.
6. Mandati i anëtarëve të bordit është 3 vjeçar me te drejtë rizgjedhjeje.
7. Në rast të vdekjes, dorëheqjes ose shkarkimit të anëtarit të bordit, Kuvendi i Anëtarëve duhet të zgjedh kandidatin me më së shumti vota në listën e pritjes, për të shërbyer për kohën e mbetur.
8. Në strukturat udhëheqëse, për shkak të përfaqësimit sa më të denjë të komunitetit, një medium nuk mund të ketë më shumë se dy anëtarë në bord të AGK-së. Lejohet kandidimi i më shumë se dy personave brenda një mediumi, por vetëm dy prej tyre do të mund të bëhen pjesë e strukturave udhëheqëse të organizatës në rast se ata mbledhin vota të mjaftueshme në listën e përgjithshme të kandidatëve.

Neni 8

Kryetarja/i

1. Kryetarja/i e/i AGK-së do të jetë përfaqësues i Asociacionit dhe do të veprojë në pajtim me vendimet e përgjithshme të Kuvendit dhe Bordit. Kryetarja/i zgjedhet sipas procedurës së përcaktuar në nenin 5.3.
2. Kompetencat e kryetares/it janë:

Zbaton politikat e përgjithshme të AGK-së, të miratuara nga kuvendi në pajtim me rregullat dhe normat e këtij statuti.

Udhëheqja e mbledhjeve të kuvendit dhe bordit.

Mbikëqyrë punën e stafit ekzekutiv.

Përfaqëson organizatën para organeve relevante të pushtetit vendor dhe jashtë vendit. Këtë detyrë mund ta delegojë tek anëtarët e tjerë të bordit, Drejtoresha Ekzekutive/Drejtori Ekzekutiv apo Stafi Ekzekutiv.

Kryen punë të tjera të përcaktuara me këtë statut dhe sipas kërkesës së kuvendit dhe bordit.

3. Mandati i Kryetares/it të AGK –së, është 3-vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.

Neni 9

Drejtoresha Ekzekutive/Drejtori Ekzekutiv

1. Drejtoresha Ekzekutive/Drejtori Ekzekutiv zgjidhet nga bordi sipas procedurave të përcaktuara në nenin 7. Propozimi i kandidatëve mund të bëhet me shkrim nga anëtarët e bordit apo përmes konkursit të hapur.
2. Drejtoresha Ekzekutive/Drejtori Ekzekutiv ushtron funksionin e saj/tij bazuar në qëllimet e AGK-së, të autorizimeve dhe udhëzimeve të bordit.
3. Drejtoresha Ekzekutive/Drejtori Ekzekutiv i parashtron raport të punës dhe raport financiar bordit, sa herë që ky i fundit kërkon.
4. Drejtoresha Ekzekutive/Drejtori Ekzekutiv merr pjesë në të gjitha mbledhjet e bordit dhe kuvendit pa të drejtë vote.
5. Mandati Drejtoreshës Ekzekutive/Drejtorit Ekzekutiv është 3-vjeçar, pa kufizim për rizgjedhje. Në rast të skadimit të mandatit paraprakisht nuk ka filluar procedura për rizgjedhjen e drejtoreshës së re/ drejtorit të ri, kontrata/mandati i vazhdohet me automatizëm edhe për 3 vjet.

Neni 10

Zyrtarët dhe nëpunësit

Në rast nevoje Bordi, në koordinim me Drejtoreshën Ekzekutive/Drejtorin Ekzekutiv, mund të emërojë zyrtarë ose të pranojnë persona që të marrin përsipër kryerjen e detyrave ditore të organizatës. Kohëzgjatja e punësimit të tyre dhe pagesa varet nga projektet në të cilat angazhohen.

Neni 11

Përdorimi i të hyrave

1. AGK mund të pranojë dhurata, poste dhe donacione mirëpo gjithashtu mund të kërkojë mënyra të tjera të fitimit të beneficioneve për punën e vet. Këto të hyra duhet të përdoren ekskluzivisht për mbështetjen e qëllimeve jo-profitabile të Asociacionit.
2. Prona e AGK-së nuk mund të ndahet as ndërmjet anëtarëve të saj, as ndërmjet anëtarëve të Bordit e as ndërmjet punëtorëve.

Neni 12

Shpërbërja e organizatës

1. Asociacioni mund të shpërbëhet me vendimin e shumicës së anëtarëve të Kuvendit.
2. Kur të vendosë për shpërbërjen e organizatës, Kuvendi do të tregojë emrin e shoqatës ose fondacionit që do të marrë pasurinë e mbetur pasi të jetë liruar nga detyrimet e organizatës. Shoqata(t) ose fondacioni(et) e zgjedhura duhet të kenë qëllime të njëjta ose të ngjashme sikurse Asociacioni.

Neni 13

Ndryshimet e statutit

Statuti mund të ndryshohet me vendimin e shumicës së anëtarëve të kuvendit, me propozim nga kryetarja/ime shumicë votash nga anëtarët e bordit.

Neni 14

Periudhat e raportimit dhe viti financiar

1. Bordi, Kryetarja/i dhe zyrtarët e emëruar do të paraqesin raporte vjetore të punës dhe financiare në ditën e zgjedhjeve të AGK-së.

2. Viti financiar i organizatës do të përputhet me vitin kalendarik. Ky statut është aprovuar unanimitisht nga Kuvendi i AGK-së.

Neni 15

Reagimet e AGK-së

1. Vendimmarrja PRO reagimit bëhet në rast kur sigurohet vota PRO e 5 anëtarëve të bordit nga 9 sa janë gjithsej, përfshirë kryetaren/in e bordit të AGK-së.
2. Bordi i AGK-së nuk reagon në përkrahje të politikave redaktoriale të medieve.
3. Bordi i AGK-së reagon në raste kur sulmohen, qoftë fizikisht apo verbalisht, fyhen, linçohen, kërcënohen, etiketohen gazetarët, kameramanët, fotoreporterët, lidhur me punën profesionale të tyre.

Neni 16

Ky statut hynë në fuqi ditën e miratimit dhe nënshkrimit të tij nga Kryetarja/i e/i AGK-së.